



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 7/1, DATË 5.12. 2016

PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME POTENCIAL STRATEGJIK ALBPANEL

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 21 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë, vlerësoi:

- Vlera e investimit të projektit “Albpanel” plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) Milion Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës së realizimit të investimit dhe operimit, numri i personave të punësuar do të jetë 300 persona.
- Projekt do të realizohet nga subjekti Albpanel NGR, NUIS/NIPT: L61605017K
- Projekti parashikon realizimin e një impianti të prodhimit të paneleve MDE duke përdorur si lëndë të parë kallamin dhe mbetje të çdo lloji produkti agro-bujqësor me përbërje fibroze.

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e asistuar” për projektin e investimit me potencial strategjik Albpanel, me kusht që subjekti investues të nënshkruajë marrëveshje të garancive financiare me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
2. Statusi strategjik “Investim strategjik me procedurë të asistuar” i jepet projektit të investimit “Albpanel”, për një periudhë dy vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të truallit në Libofshë, Fier, për ndërtimin e fermës së kallamave dhe truallit për ndërtimin e fabrikës të prodhimit të paneleve MDE, të cilat do të

vendosen respektivisht me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshjen përkatëse që do të nënshkruhet me Bashkinë Fier.

3. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:
 - a) Kryerje e procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
 - b) Asistencë në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit;
 - c) Infratsrukturë ndihmëse energjetike;
 - d) Miratimin në parim dhe lejimin e përdorimit të truallit për kultivim kallami dhe mbarështim buallice, Libofshë, Zona kadastrale 2443 dhe Remas, Zona kadastrale 2085.
 - e) Miratimi përfundimtar, si dhe sipërfaqja, mënyra, afatet, kostot e lejimit të përdorimit të truallit në funksion të realizimit të fermës së kallamit do të përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, sipas procedurave të legjislacionit për investimet strategjike.
4. Ky vendim miraton dhe planin e veprimit për çdo masë mbështetëse të kërkuar nga Shteti Shqiptar dhe miratuar me vendim të KIS.
5. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Albpanel” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e asistuar, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
6. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
7. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK ALBPANEL

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejtuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejtuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit Albpanel

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit Albpanel, projekt me potencial strategjik, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit Albpanel është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

3. Hapat procedurale

Propozimi nga investitor:

Investitori Albpanel NGR kur paraqiti projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin ka specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkon për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandim	Institucion i përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar në faza. Detyrime t sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
<p>Tokë bujqësore për kultivim kallami dhe mbarështim buallice, me tarifën simbolike 1 €</p> <p>Sipërfaqe e synuar 200 Ha</p> <p>Zona e</p>	<p>PO</p> <p>Projekti i investimit të ndihmohet nga Shteti Shqiptar duke i vënë në dispozicion sipërfaqen e synuar në zonën kadastrale Nr. 2443.</p>	<p>MBZHRAU</p>	<p>Vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme shteterore për zhvillimin dhe realizimin e projekteve investuese strategjik</p>			

<p>synuar: Libofshë, Zona kadastrale 2443 dhe Remas, Zona kadastrale 2085</p>	<p>Parcelat e sakta do të identifikohen nga MBZHRAU</p> <p>Subjekti duhet t'i vërtetojë KIS mundësinë reale të financimit të projektit.</p> <p>Do të nënshkruhet marrëveshjet e garancive financiare ndërmjet subjektit investues dhe MZHETTS</p>	<p>MZHETTS</p>	<p>e, rregullohet rast pas rasti, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin mbi administrimin e pronës publike.</p>			
--	---	-----------------------	---	--	--	--

		MM	<p>Projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së VNM, referuar Ligjit Nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndyshuar, sipas procedura ve të përcaktuara në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve</p>	<p>Procesi i VNM-së ka disa procedura aplikimi në varësi të projektit</p>	<p>Sipas legjislativacionit sektorial, afati paras hikohet: 45 - 160 ditë,, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM.</p> <p>Aplikimi për këto akte administrative do të trajtohet me procedura</p>	<p>Tarifa për MM: 30 000-50 000 All, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM</p>
--	--	-----------	--	---	---	---

			për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore ”		të përshpejtuarra, sipas afateve të përcaktuara në legjislativon për investimet strategjike.	
<p>Tokë për ndërtim fabrike.</p> <p>S= 60,000 m² sa më pranë lëndës së parë.</p> <p>Fshati Agim, Libofshë, Zona kadastrale me nr.pasurie 25/20, nr. 1005.</p>	<p>PO</p> <p>Projekti i investimit të ndihmohet nga Bashkia Fier duke i vënë në dispozicion sipërfaqen e synuar në fshatin Agim, Libofshë, ose një alternativë tjetër trualli, në të njëjtat kushte, të përshtatshë</p>	<p>BASHKIA FIER</p>				

	<p>m sipas planit të biznesit të projektit.</p>	<p>MM</p>	<p>Projekti duhet t'i nënshtrohet et procedurës së VNM referuar Ligjit Nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndyshuar, sipas procedurave të përcaktuara në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së</p>	<p>Procesi i VNM-së ka disa procedura aplikimi në varësi të projektit</p>	<p>Sipas legjislativës sektorial, afati parashtesë: 45 - 160 ditë,, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM.</p> <p>Aplikimi për këto akte administrative do të trajtohet</p>	<p>Tarifa për MM: 30 000-50 000 All, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM</p>
--	---	------------------	---	---	--	---

			<p> vlerësimet të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurë s së transferi mit të vendimit dhe deklaratës mjedisore ”, ashtu si dhe referuar Ligjit Nr. 10448/20 11 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar , të aplikojë për t’u pajisur me leje mjedisi sipas përcaktim eve të VKM Nr. 419/2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimi n e kërkesave </p>	<p> Në varësi të projektit, mund të aplikojë për leje mjedisi të tipit A, B ose C, </p>	<p> me proce dura të përsh pejtua ra, sipas afatev e të përca ktuara në legjisl acioni n për invest imet strate gjike. </p> <p> Sipas legjisl acioni t sektor ial, afati paras </p>	<p> Tarifa për MM: 10 000- 50 000 All, në varësi të lejes së mjedist që do të duhet të aplikojë </p>
--	--	--	---	---	---	--

			<p>për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja (QKL)”</p>		<p>hikohet: 25-60 ditë pune në varësi të lejes së mjedisit që do të duhet të aplikojë. Apliki mi për këto akte administrative do të trajtohet me procedurën përshpejtuar, sipas afateve të përcaktuara</p>
		MZHU			

			<p>Të ndiqen hapat e përcaktuar në ligj për miratimin e lejeve ndërtimore. Subjekti duhet të plotësojë aplikimin për pajisje me leje ndërtimi dhe infrastrukturë, në përputhje me Nenin 15, VKM Nr. 408, datë 13.05.2015</p>		<p>në legjislacionin për investimet strategjike.</p>	
--	--	--	--	--	--	--

<p>Furnizim me energji elektrike, linja TN</p>	<p>PO</p>	<p>MEI</p> <p>OSHEE</p> <p>FIER</p>	<p>Projekti duhet t'i nënshtroh et procedura ve të percaktuarra për Lidhjet e Reja, duke ju drejtuar operatorëve të rrjetit për dhënien e pikës së lidhjes.</p> <p>Strukturat që merren me realizimin e lidhjes së re janë:</p> <p>1.Kujdesi ndaj klientit(nisja e procedurës nga aplikanti)</p> <p>2.Zyrat e lidhjeve të reja në rajone (nqs fuqitë e instaluara per te cilat kerkohet lidhja e re jane nën</p>	<p>1.Kërkesë me shkrim pranë zyrave të OSHEE për pikë lidhje të re</p> <p>2. Përgatitja e dokumentacionit përkatës</p> <p>3.Miratimi nga ana e OSHEE e pikës së lidhjes</p> <p>4.Nënshkrimi i akt marrëveshjes midis kompanisë dhe aplikuesit</p> <p>5.Kryerja e punimeve</p> <p>6.Kryerja e pagesës sipas preventivit përkatës</p> <p>7.Lajmërimi në kompani për përfundimin e punimeve</p> <p>8.Verifikimi dhe kontrolli nga ana e OSHEE të punimeve që janë kryer para vënies në tension të paisjeve</p>	<p>Koha që duhet për realizimin e një lidhje të re varion sipas fuqive nga 15 ditë deri 45 ditë.</p> <p>Kjo procedurë do të trajtohet me afatetë përshpejtuarra, sipas parashikimeve të Nenit 23 të Ligjit Nr. 55/20</p>	<p>Tarifat janë në varësi të projektit dhe percaktohen nga operatori i rrjetit.</p> <p>-T1,tarifa për studimin dhe vlerësimin e miratimit të projektit</p> <p>-T2,tarifa e shërbimeve për realizimin e lidhjes së re</p> <p>-T3,tarifa e fuqisë</p> <p>-T4, tarifa për kolaudimin fillestar të matësit të energjisë</p>
---	------------------	--	--	---	--	---

			<p>50kë)</p> <p>3. Zyrat e lidhjeve të reja në Drejtorinë Qendrore në Tiranë (nqs fuqitë e instaluara janë mbi 50 kë)</p> <p>4. Grupet e asistencës teknike në rajone për realizimin e lidhjes së re dhe montimin e matësave</p> <p>5. Zyra e menaxhimit të kontratave në drejtorinë qendrore për finalizimin e procedurës duke nxjerre kontratën për lidhjen e re.</p>	<p>9. Pajisja me matës të energjisë sipas fuqive përkatëse</p> <p>10. Dhënie tension (në rast se gjatë vënies ne tension të objektit lindin probleme në paisjet që realizuan lidhjen, të instaluara nga aplikanti, atëherë aplikanti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparojë pjesën e dëmtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionojë normalisht)</p> <p>11. Përfundimi i procedurës me daljen në sistemin e faturimit të kontratave përkatëse.</p> <p>Dokumentacioni</p>	15	elektrike
--	--	--	---	---	----	-----------

				<p>1.Kërkesë për pikë lidhje të re (projekti elektrik i objektit dhe pikës së transformacionit i miratuar paraprakisht në IQT në qofte se fuqitë e instaluara janë mbi 20KË)</p> <p>2.Leje ndërtimi</p> <p>3.Vërtetim pronësie apo leje të tjera të veçanta për zhvillim</p> <p>4.Nipt +ekstrakt QKB të subjektit aplikues</p> <p>5.Kartë identiteti e personit përfaqësues</p> <p>6.Plan vendosje e objektit në formatin A-3 në sh:1 me 500</p> <p>7.Parametrat nominal të të gjitha paisjeve elektrike të përfshira në</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		MM	<p>Projektin elektrik</p> <p>8.Raport i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritja e të dëenave të kryera nga inxhinierë me licencë</p> <p>9.Relacion analitik për vlerësimin e cos fi dhe kompesimin e saj</p> <p>10.Licencë e ing.elektrik i cili ka bërë projektin e noterizuar</p> <p>Procesi i VNM-së ka disa procedura aplikimi në varësi të projektit</p>	<p>Sipas legjislativacionit sektorial, afati parashikohet: 45 – 160 ditë,, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM.</p> <p>Aplikimi për këto</p>	<p>Tarifa për MM: 30 000-50 000 All, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM</p>
--	--	-----------	--	---	---

			<p>rregullave , të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore</p>		<p>akte administrative do të trajtohet me procedurën përshpejtuar, sipas afateve të përcaktuara në legjislativon për investimet strategjike.</p>	
<p>Infrastrukturë rrugore. Akses në rrjetin rrugor të zonës për lidhjen e fermës dhe fabrikës</p>	<p>Nëse subjekti vendos të investojë në ndërtimin e rrugës, të asistohet për hapat procedural e dhe dokumenta</p>	<p>BASHKIA FIER MM</p>	<p>Projekti duhet t'i nënshtrohet et procedurës së VNM, referuar Ligjit Nr. 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në</p>	<p>Procesi i VNM-së ka disa procedura aplikimi në varësi të projektit</p>	<p>Sipas legjislativonit sektorial, afati parashikohet: 45 - 160 ditë,,</p>	<p>Tarifa për MM: 30 000-50 000 All, në varësi të aplikimit që do të kryhet për VNM</p>

	cionin		<p>mjedis”, të ndyshuar, sipas procedura ve të përcaktuara në VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore</p>		<p>në varësi të apliki mit që do të kryhet për VNM.</p> <p>Apliki mi për këto akte administrative do të trajtohet me procedura të përshpejtuar, sipas afateve të përcaktuara në legjislativon për investimet strate</p>	
--	--------	--	---	--	---	--

					gjike.	
Furnizim me ujë dhe sistem kullimi	Rekomandimi nga Bashkia Fier është që subjekti të shpojë puse pasi zona nuk ka ujë.	BASHKIA FIER MM	Projekti duhet t'i nenshtrohet et procedurës së VNM referuar ligjit 10440/2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndyshuar, sipas procedurave të përcaktuara në VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së	Nuk mund të përcaktohet në këtë fazë pasi procesi i VNM-se ka disa procedura aplikimi në varesi të projekti dhe pa u detajuar projekti nuk mund të shprehem	45 – 160 dite, në varesi të apliki mit që do të kryhet per VNM	Tarifa per Ministrin e e Mjedisit 30 000-50 000 All varesi te aplikimit që do të kryhet per VNM

			vlerësimet të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurë s së transferi mit të vendimit dhe deklaratës mjedisore ”			
--	--	--	--	--	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTËR I FINANCAVE

ARBEN AHMETAJ

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

MILVA EKONOMI

MINISTËR I BUJQËSISË ZHVILLIMIT URBAN DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE

EDMOND PANARITI

MINISTËR I MJEDISIT

LEFTER KOKA

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

SOKOL DERVISHAJ

ZËVENDËS MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIËS

ILIR BEJTJA

ZËVENDËS MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

GJON RADOVANI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT
ALMA HICKA